Gjimnazi “Qemal Stafa”

Në vijim të fushatës informuese dhe ndërgjegjësuese, ***në datë 20 maj 2022,*** stafi i institutit Shqiptar për Çështjet Publike - AIPA zhvilloi takimin e hapur informues me nxënësit në gjimnazin “Qemal Stafa”.

Edhe në këtë gjimnaz, orët e hapura informuese dhe ndërgjegjësuese u zhvilluan me nxënës të klasave të 10 dhe 11, dhe fokusi kryesor i tyre ishte informimi dhe ndërgjegjësimi i fëmijëve dhe të rinjve lidhur me rreziqet me të cilat ata mund të përballën nëse qëndrojnë të pambrojtur për një kohë të gjatë në internet. Në këtë kuadër stafi i AIPA-s, i përbërë nga profesionistë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, psikologë, si dhe specialist IT ndau me nxënësit disa këshilla praktike lidhur me përdorimin e sigurtë të internetit si dhe qëndrimin e tyre online në një mënyrë dhe kohë sa më cilësore.

Gjithashtu, nxënësit u informuan dhe mbi mekanizmat e raportimit si dhe mbi institucionet dhe profesionistët ku ata mund të drejtohen në momentin kur do të përballen me vështirësi, sfida apo probleme nga më të ndryshmet përgjatë qëndrimit të tyre online.

Të paktën një mësues/e ishte prezent/e në klasë përgjatë zhvillimit të fushatës informuese dhe ndërgjegjësuese, kjo me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin edhe të tyre mbi mënyrat dhe mekanizmat e ofrimit të ndihmës për fëmijët dhe të rinjtë, si dhe institucioneve për raportimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve online.

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit me zyrën e Këshillit të Evropës në Shqipëri (KiE), në çdo klasë u shpërndanë dhe materjale informuese mbi edukimin e qytetarisë digjitale, të përgatitura prej tyre.

AIPA është organizatë partnere në zbatimin e projektit "Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri", në gjimnazet "Aleks Buda", "Qemal Stafa", "Sami Frashëri" dhe "Sinan Tafaj", në qytetin e Tiranës. Projekti "Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri" zbatohet nga Këshilli i Evropës (KiE) dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida).

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE
GUARDIAN OF HUMAN RIGHTS, DEMOCRACY
www.coe.int